



3109/  
Nr. .... Prot.

Tiranë, më 23.05.2012

## URDHËR

Nr. 218, datë 28.05.2012.

### PËR

**HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË "SHKENCAT E SHËRBIMEVE SHOQËRORE", "SHKENCA MODERNE ISLAME", "SHKENCA THEMELORE ISLAME" PRANË SHKOLLËS SË LARTË JOPUBLIKE "HËNA E PLOTË (BEDËR)".**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 44/1 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011 "Për licencimin e shkollës së lartë private "Hëna e Plotë" (Bedër), Tiranë.

### **URDHËROJ:**

1. Hapjen në përputhje me vendimin nr. 320, datë 16.03.2012 të Këshillit të Akreditimit (bashkëlidhur këtij urdhëri), pranë shkollës së lartë private "Hëna e Plotë" (Bedër), të programeve të studimit:
  - a) Master i Shkencave në " Shkencat e Shërbimeve shpirtërore";
  - b) Master i Shkencave në " Shkenca Moderne Islame";
  - c) Master i Shkencave në " Shkenca Themelore Islame";
2. Këto programe studimi realizohen me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në " Shkencat e Shërbimeve shpirtërore", Master i Shkencave në " Shkenca Moderne Islame" dhe Master i Shkencave në " Shkenca Themelore Islame".

3. Shkolla e lartë private "Hëna e Plotë" (Bedër), duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programe studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhëri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Shkolla e lartë private "Hëna e Plotë" (Bedër).

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.*

MYQEREM TAFAJ

  
MINISTËR

